

FILLIM I MBARE

• Më 6 korrik të vitit 1942 formohet aradha partizane manastiro — prespane «Dame Gruev». — Sulmi i parë në fshatin Smilevë. — Me sulmin në fshatin Kazhani, aradha partizane «Dame Gruev» do ta ndihmojë aradhën partizane «Dimitar Vllahov» nga Tito Velezi.

Në historinë e pasur të Luftës Nacionalçlirimtare dhe revolucionit socialist të popullit maqedonas dhe kombësive, në Prespë e Manastir (Bitollë), viti 1942 paraqet një kapitull të veçantë. Themi kështu, sepse po në këtë vit, me të madhe fillon mobilizimi i masës për luftë kundër fashistëve gjermanë, bullgarë dhe italianë, e njëherit po në këtë vit fillojnë të formohen aradhat e para partizane, të cilat me sulme të herpashershme dhe të shpejta, armikut i shkaktonin dëme të mëdha. Rëndësia e këtyre aradhave është aq më e madhe kur kihet parasysh fakti se çdo paraqitje e tyre në mjediset e banuara pritet me simpati të madhe dhe mijëra të rinj shkonin gjurmëve të tyre.

Gjashtë korriku i vitit 1942 përherë do të mbetet i shënuar në analet e historisë së LNÇ-së në Maqedoni. Sepse, po në këtë ditë u formua aradha partizane maqedonase manastiro-prespane — «Da-

me Gruev». Kjo aradhë gjatë ekzistimit të saj do të përjetojë shumë çka dhe nga shkatërrimi total do të rilindet për së dyti.

Aradha partizane «Dame Gruev» deri më 1 gusht të vitit 1942 vepron në ilegalitet. Po në këtë datë do të merret vendimi për aksionin e parë që do të zhvillohet pikërisht në ditën simbolike, më 2 gusht, pra në Ditën e Ilindenit.

Sulmi në fshatin Smilevë

Në orët e mbrëmjes të 1 gushtit, luftëtarët e kësaj aradhe do të nisën drejt fshatit Smilevë. Planin të cilin e paraqiti Shtabi i aradhës ishte sa vijon: në fshatin Smilevë do të mbahet një miting, i cili ka për qëllim festimin e Ilindenit bullgar. Andaj, me këtë rast, duke shfrytëzuar momentin duhet të likuidohet arkivi i komunës dhe kryeplaku i fshatit njëfar Kostovi, i cili bashkëpunonte me armikun.

Në orët e para të mëngjesit (2 gusht) aradha hyri në fshat dhe për një kohë të shkurtër i realizoi



Aradha partizane «Dame Gruev»

të gjitha detyrat. Në mitingun e fshatarëve, të pranishmëve u foli komesari Josif Josifovski — Gjorçe, i cili më mirë njihet me nofkën «Sveshtar». Pas mbledhjes së ushqimit dhe veshë — mbathjes që ua dhanë fshatarët, në orën 12 aradha largohet dhe merr rrugën drejt majës së malit Biglla.

Si u ndihmua aradha partizane «Dimitar Vllahov»?

Pas marshimit të gjatë, në afërsi të fshatit Jankovec, aradha do ta kalojë rrugën Resnje — Ohër dhe do të vendoset në malin Galica, përkatësisht në afërsi të fshatrave Petrino dhe Bollno. Edhe përkundër gjurmimeve të papushura të ushtrisë dhe policisë bullgare, aradha assesi nuk do të zbulohet.

Më 13 gusht, Stiv Naumovi, për-

ndryshe sekretar i Komitetit të qarkut të Manastirit, do ta vizitojë këtë aradhë dhe luftëtarët do t'i njoftojë me pozitën e pavoliteshme të aradhës partizanë «Dimitar Vllahov» nga Titov Velezi. Në të vërtetë, kjo aradhë pas aksionit të suksesshëm në fshatin Pletvar, me të madhe do të ndjeket prej bullgarëve, të cilët mendonin se edhe aksioni në Smilevë është vepër e po kësaj aradhe. Stiv Naumovi do të propozojë që të sulmohet stacioni i policisë në fshatin Kazhani që shtrihet në rrugën Resnje — Manastir, me qëllim që bullgarëve t'u tërhiqet vëmendja dhe të ndërpritet ndjekja e aradhës «Dimitar Vllahov».

(vijon)

Në numrin e ardhshëm: «HALË NË SYTË E ARMIKUT»

HALE NE SYTE E ARMIKUT

- 19 partizanë kundër 100 fashistëve bullgarë. — Tradhtia afër lumit Shemnica. — Burgosjet masive nga ana e bullgarëve. — Ndër të burgosurit edhe dy shqiptarë. — Ndërrprerja e lidhjeve.

Pas analizave dhe përgatitjeve të nevojshme, të ndarë në tri grupe, në me shtatën e 18 dhe 19 gushtit, partizanët e aradhes «Dame Gruev» ia fillojnë aksionit. Edhe pse nuk u realizua plani i paraparë, ky sulm plotësisht ashytoi qëllimin, pra shpëtimin e aradhes së Titov Velesit, «Dimitar Vllahov». Në këtë sulm që u zhvillua me shpejtësi të madhe, për fat të mirë, as njëri nga luftëtarët nuk humbi jetën, e as që u plagos por edhe nuk pati ndonjë sukses. Më në fund, diçka edhe më shumë nu pritej, sepse aradhja numronte gjithsej vetëm 19 partizanë, kurse në anën tjetër fshin afër 100 fashistë bullgarë. Përpos kësaj, aradhja në fjalë, në radhët e veta kishte vetëm një pushkomi traloz e asnjë automatik, që në sulmet e papritshme luan rol vendimtar.

Tradhtia

Më 22 gusht, luftëtarëve do t'u urdhërohet që të përgatiten për sulm të ri. Po gjatë kësaj dite, ata do të befasonen nga dezertimi i Pepo Pesos, i cili edhe më parë ankohej se ka probleme me sytë. Pak para mbërmjes, aradhja lëshohet në anën e majtë të lumit Shemnica, në afërsi të fshatave Lera dhe Dolenci. Pas një kohë, duke kaluar lumin, papritmas do të dëgjohet një rrebesh i plumbave. Luftëtarët të habitur nga ky kurth, të ndarë në për grupe tërhiqen nga mali Biglla, e prej andej në malin Galicica, në llogorin e mëparshëm. Në këtë sulm të fashistëve bullgarë, lehtë u plagos vetëm luftëtari Pe-

Bozhinovski — Koço. Ishte e qartë se aradhja që tradhëtohet. Më vonë do të kuptohet se kjo që vepër e njëfarë Canes dhe rojtarit të fshatit Lera, Llazos. Në fshatin Dolenci, disa ditë më vonë do të fillojnë burgosjet masive, sidomos të anëtarëve të qelulave partizane. Në mesin e të burgosurve qenë edhe dy anëtarë të KPJ nga kombësia shqip-

tare: Baftiar Veliov dhe Kadri Rushid Qerimov.

Pas përleshjes me fashistët bullgarë pranë lumit Shemnica, aradhja u nda në tri grupe. Katër luftëtarë — Koço, Jane, Tunelo dhe Spiroja kalojnë në Ma nastir (Bitollë). Pas disa ditëve Janen e zunë bullgarët, kurse tre të tjerët i bashkangjiten aradhes së posaformuar «Jane Sandan-

ski». Grupi i dytë arrin në vendin e caktuar në afërsi të fshatit Bollno, ndërkaq Josif Josifovski dhe Ilija Ignjevski — Cvetan që përbënin grupin e tretë, kalojnë në territorin e okupatorëve italianë, në fshatin Pomoçani (Prespë).

Ndërrprerja e lidhjeve

Në fund të gushtit të vitit 1942 Gjorçe Sveshtarit

dhe Ilija Ignjevskit i bashkohen edhe gjashtë partizanë të rinj nga regjioni i Prespës: Jordan Naumovski — Kallço, Kosta Kusakovski — Save, Ico Gilboçki — Mirçe, Kërste Ivkov — Vellko, Krume Dimitrovski — Sllobodan dhe Leon Vogriç, slloven nga Istria, i cili kishte dezertuar nga ushtria italiane.

Aradhja partizane «Dame Gruev» gjatë kësaj kohe u bë halë në sytë e fashistëve bullgarë, të cilët filluan të marrin masa represive ndaj anëtarëve të qelulave partiake. Të gjithë ata u malltretuan në mënyrë mizore, porse askush nuk tregoi se ku gjendet aradhja.

Më 11 shtator, komesari Josif Josifovski kot priste lidhjen e caktuar me Mite Bogoevskin. Në të vërtetë, Tashko Filipovski nga Resnja kupton për organizimin e ndjekjes së aradhes nga ana e bullgarëve. Këtë informatë Tashkoja ia përcjell Sandre Gerasovit nga fshati Bollno, i cili punonte si postier, e ky i fundit Stiv Naumovit. Me vendimin e Shtabit të aradhes, Stivit dhe Mites, aradhja më 11 shtator kalon në malin Biglla, ku edhe që planifikuar të vendosen lidhjet e nevojshme. Më 12 shtator, pas pritjes së kotë, Gjorçe Sveshtari dhe Sllave Ilievski, në fshatin Kriveni takohen me vëllain e Sllaves, Sterion.

(vijon)

Në numrin e ardhshëm:
»NJË BUKË NE SHITAT-
TEMBËDHJETË PIESE«

Sh. HALIMI



Luftëtarët e aradhes «DAME GRUEV» në malin GALIÇICA

GJURMËVE TË ARADHËS PARTIZANE «DAME GRUEV» (3)

NJE BUKE NE SHTATEMBEDHJETE PJES

- Vrasja e Mite Bogoevskit dhe Stiv Naumovit. — Aksioni i katërt i aradhës në fshatin Sopotsko. — Një pjesë e aradhës në territorin e okupacionit bullgar, kurse pjesa tjetër në ate italian.

Sterio Ilievski ngarkohet me detyrë që të shkojë në fshatin Bollno dhe të kuptojë se përse nuk u vendos lidhja e nevojshme. Ai kthehet dhe tregon se Mite Bogoevski dhe një i panjohur janë vrarë dhe se shumë të tjerë u burgosën. Gjitha shtu kupton se në fshatin Jankovec është zënë edhe një partizan sloven, gjegjësisht Leon Vogriçi që kish te dezertuar nga radhët e ushtrisë italiane. I panjohuri që u vra me Miten, siç u kuptua më vonë, ishte Stiv Naumovi. Pas tërë kësaj, aradha do të mbetet e vetmuar, sepse të gjitha lidhjet me aktivitet tjerë u ndërprejnë.

Aksioni i katërt

Fashistët bullgarë për çdo javë e kontrollonin malin Biglla, por aradhën asskesi s'mund ta zbulonin. Pas tri ditëve të kaluara në Kurjak, të gjithë luftëtarët kalojnë në vendin e qu

ajtur Gorni Rid, ku do të qëndrojnë më shumë se një muaj, përkatësisht deri më 20 tetor të vitit 1942. Kjo periudhë për aradhën do të jetë jashtëzakonisht e rëndë, sepse shumë vështi rë sigurohej ushqimi. Shpesh ndodhte që gjatë ditës një bukë ta ndajnë në shtatëmbëdhjetë pjesë sa edhe ishin.


Të gjitha shpresat për ta gjetur ndonjë lidhje ishin tek Sterio Ilievski, i cili kupton se në aksionin për zbulimin e ihtarëve të PKJ-së nuk është burgosur Dimo Beqari. Nga ai kërkohet që të krijohet lidhja e re me Manastirin (Bito-lën). Më 10 nëntor me vendimin e Shtabit të aradhës, Ilija Spirovski së bashku me Mito Trajçevskin — Malçikun nisen për në fshatin Slepçe me ç'rast duhej të vendoset lidhja me Manastirin. Pas pritjes së kotë pesëditëshe sërish kthehen pa kuptuar se bëhej

fjalë për një mosmarrëveshje, sepse lidhja do të arrijë një javë me vonesë.

Në përgatitje e sipër ishte plani për aksionin e katërt të aradhës. Më 20 dhe 21 tetor luftëtarët e aradhës «Dame Gruev» do të qëndrojnë afër fshatit Sopotska dhe do ta studiojnë situatën, ndërkaq më 22 tetor do të futen brenda në fshat. Pas mbledhjes së ushqimit dhe fjalimit të Ilija Spirovskit para fshatarëve, të cilët deri në atë kohë kishin menduar se aradha nuk ekziston më, sillet vendimi për t'u larguar.

Ndarja e aradhës

Gjatë qëndrimit të partizanëve në fshatin Sopotsko, kryeplaku i fshatit, me anë të një nxënësi, dërgon letër në Resnje për t'i lajmëruar policisë se ku gjendet aradha. Brenda një kohe të shkurtër bullgarët arrijnë dhe në përlesh-



Stiv Naumov

je e sipër me partizanët torin e okupacionit bullgar vritet luftëtar Sterio Geor e tjetra në atë italian. giev — Zhorzh. Fill pas tër Sllave Ilievski — Stevo heqjes, një pjesë e aradhës dhe Krume Dimitrovski — që ishte ngarkuar me de Sllobodan, 16 ditë do të qëndrojnë në Gërçar. Me vde tyrrë për sigurimin e ushqimit do të marrë një anë kjen e Kosta Kukasovskit krejtësisht tjetër, do të gjatë tentimit të likuidimit të spiunit Trajko Kazhanov pacionit italian. Duke u gjeskit nga fshati Podmoçani, tur në një situatë të kë pas djegies së shtëpisë së tillë, pjesa e mbetur e Cvetko Kusakovskit — ba aradhës në dy grupe, njëra bait të Kallços si dhe pas mbetet në malin Biglla, kur burgosjes së disa anëtarëve se tjetra mezi bashkohet të Partisë, situata në Prespë me grupin e parë në fshat keqësohet shumë. tin Pddmoçani (Prespë). Pas (vijon) kësaj, gjendja e aradhës do të vështirësohet edhe më Në numrin e ardhshëm: shumë, ngase njëra pjesë »KUSH ISHTE MIÇO SO-TIRI?! rët arrijnë dhe në përlesh e aradhës mbetet në terri

Sh. Halimi

KUSH ISHTE MIÇO SOTIRI?!

• Ç'iu kujtua Krume Dimitrovskit? — Takimi i Krumes me Tomo Papin. — Shkuarja në Korçë. — Behar Shtila në shokët ftojnë Josif Josifovski — Gjorçe Sveshtarin

Duke parë rrezikun, Sllave Ilievski shkon në fshatin Kriveni kurse Krume Dimitrovski në fshatin Konjsko, ku përpak shpëton nga italianët. Në të vërtetë, Krumen e shpëton Jordan Tasevski nga fshati Konjsko, i cili njëherit ishte edhe lidhja kryesore partiake mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Ideja për të shkuar në Shqipëri

Pas takimit me Jordanin, Krumes do t'i lind një ide



Ishim të bindur se aradha partizane «Dame Gruev» do të qëndrojë deri në fund — Zhivko Stefanovski

interesante për ta shpëtuar të ardhën, kështu që Jordanit i propozon që sipas mundësive ta lidh me anëtarët e Partisë komuniste të Shqipërisë, për të biseduar lidhur me mundësinë, për dalje në territorin e tyre dhe për ta kaluar dimrin e rëndë dhe të ftohtë. Lidhur me këtë moment, Krume Dimitrovski thotë se kjo vetëiniciativë sado që si ide ishte e mirë, në vete kishte edhe rrezik të papërshkruar. Sepse, këtë mundësia ta paguaj edhe me kokën time, porse, meqë kërkohej rrugëdalje, s'kisha aq kohë për të menduar, thotë Dimitrovski.

Në fshatin Glloboçani, Krumeja me ndërmjetësimin e Jordanit do të takohet me Tomo Papin, anëtar i PKSH, i cili njëherit ishte edhe kryetar i komitë së Glloboçanit në qeverinë shqiptaro-italiane. Krumeja, Tomos do t'i thotë se është delegat i aradhes partizane «Dame Gruev» dhe se është dërguar për të gjetur gjuhë të përbashkët lidhur me daljen e aradhes në territorin e tyre, ngase ekziston rreziku që aradha të shpartallohet krejtësisht. Edhe pse takimi ishte i

ngrohtë dhe i përzemërt, Tomoja, Krumes do t'i thotë se asgjë nuk është e sigurtë përderisa vetë (Krumeja) nuk shkon në Korçë për të biseduar me anëtarët e Komitetit të qarkut. Me këtë rast, Krume Dimitrovski — Sllobodani do të marrë letërnjoftim të ri me emrin Miço Sotiri, ndërkaq vendbanim i përhershëm do t'i caktohet fshati Glloboçani.

Takimi i Krumes me Behar Shtilën

Pas disa ditëve nga Korça arrin lajmi se Miço Sotiri (Krume Dimitrovski) mund të niset për t'u takuar me anëtarët e Komitetit të qarkut. Kështu, me 3 dhjetor të vitit 1942, i shndërruar si shitës i thëngjilit, Miçoja së bashku me disa fshatarë niset drejt Korçës, me ç'rast do të takohet me njëfarë Ilija Budinski, i cili atëbotë punonte si bukëpjekës. Me 7 dhjetor, në shtëpinë e Ilisë, Miçoja do të takohet me Behar Shtilën dhe me disa shokë tjerë, të cilëve do t'u tregojë shkallën e ardhjes Shokët nga Korça, në bisedë e sipër shprehën dëshirë që të takohen me komesarin Josif Josifovskin. Me 8 dhjetor

Miçoja, Josifovskit do t'i shkruajë letër me këtë përmbajtje:

»Shoku Josif, unë Krume Dimitrovski — Sllobodani gjindem në Korçë. Lidhjen e gjeta me anë të Jordanit nga fshati Konjsko me të cilin u morëm vesh që gjithsesi ta shpëtojmë aradhen tonë nga gjendja e vështirë që na kaploi. Jordani m'u paraqit vetë dhe mund të them se është një trim i radh. Këtu, përmes një lidhje tjetër, u takova me anëtarët e Komitetit të qarkut, në mesin e të cilëve ishte edhe sekretari i komitetit, Behar Shtila si dhe sekretari i Komitetit të qarkut, Ilija Budinski, tek i cili edhe jam vendosur. Këta shokë shprehin gatishmëri që ta pranojnë aradhen tonë, por së pari dëshirojmë që personalisht të takohen me juve, pra duhet të vijnë këtu në Korçë. Në kë-



Miço Sotiri alias krume Dimitrovski

të anë gjenden nëntë fshatra maqedone, të cilave, siç thonë shokët e këtushëm, duhet t'u ndihmojmë për disa punë organizative. Ç'është e mirja, këtu shumë pak ka ushtarë të armikut. Shoku Josif të lutem eja, mos ke frikë, sepse çdo gjë është në rregull. Në se vini, atëherë shfrytëzoni kanalin e njëjtë nëpër të cilin kalova unë. Pra kanali gjindet në fshatin Glloboçani, përkatësisht te Pandë Komita, te kryetari i komitës Tomo Papi dhe te mësuesi (shqiptar) Ilija. Lidhjen e mëtutjeshme do t'ua tregojë shoku Tome.

Bukëpjekësi Ilija këtë letër e dërgon në fshatit Glloboçani dhe ia dorëzon Tomos, i cili që atëherë e çon për në fshatin Konjsko.

(Vijon)

Në numrin e ardhshëm:
«ARADHA NË SHQIPËRI»
Sh. Halimi

ARADHA NE SHQIPERI

● **Më 19 dhjetor të vitit 1942 Josif Josifovski në Korçë.**

— **Biseda e parë. — Ç'propozoi Ilija Budinski? — Ta-**

kimi i shokëve në shtëpinë e Pande Komitës.

Josif Josifovski — Gjorçe Sveshtari për shkak të sëmundjes që e kishte kapluar qysh më parë, që dërguar për shërim në Prespë, gje gjësisht në regjionin e fshatit Pokërvenik. Më 17 dhjetor, ai mban një takim me banorët e fshatit Oteshevë dhe pas kësaj me një pjesë të aradhës shkon në një shpellë të malit Galicica. Këtu e dhe e pranon letrën nga Korça që ia kishte dërguar Miço Sotiri, alias Krume Dimitrovski.

Josif Josifovski — Gjorçe në Korçë

Pa u hamendur shumë së bashku me Mite Tërpevski — Vojvodën ai zbrit në afërsi të fshatit Shurleci dhe hip në një autobus që qarkullonte në relacionin Carev Dvor — Korçë. Për shkak të lidhjes që e priste në fshatin Glloboçani, ai zbrit nga tri kilometra larg fshatit dhe fshehtas arrin tek Pande Komita, i cili e çon te Tomo Papi. Kryetari i komunës së fshatit Glloboçani (Tome Papi) së shpejti i nxjerr një letërnjoftim të ri dhe fton mësuesin Ilija për të shkuar në Korçë, gjegjësisht në

shtëpinë e Ilija Budinskit së bashku me Gjorçe Sveshtarin. Më 19 dhjetor, komesari arrin në Korçë ku takohet me Miço Sotirin dhe nikoqirin Budinski.

Ditën e njëjtë, në mbrëmje, sho kët e Komitetit të qarkut të Partisë komuniste të Korçës, në krye me sekretarin Behar Shtila, i llojnë bisedimet e para me Josif Josifovskin. Me këtë rast, Behar Shtila do të thotë: «Ju lejojmë që aradha juaj të qëndrojë në fshatrat maqedonase, por është mirë që pa lejen tonë mos të futeni nëpër fshatrat e shqiptarëve, sepse armiqët tanë, ballistët, këtë do ta shfrytëzojnë si material propagandues për t'i thënë popullit, ja partizanët maqedonas janë futur në atdheun tonë dhe dihet se komunistët partizanë luftojnë kundër neve që dëshirojmë ta krijojmë Shqipërinë e madhe».

Aradha partizane «Dame Gruev» kalon në trritorin e Shqipërisë

Në bisedë e sipër, Ilija Budinski do të propozojë që aradha ta vizitojë fshatin Progri, me ç'rast fshatarët shqiptarë do të mund të bin-

deshin se ka edhe popuj tjerë që luftojnë kundër fashistëve. Ky propozim njëzërit u miratua nga të gjithë ata që ishin të pranishëm.

Të nesërmen Gjorçe Sveshtari do t'i shkruajë letër Ilija Spirovski — Pandes dhe Mite Tërpevski — Vojvodës, i cili ishte zëvendës i tij dhe do të urdhërojë që të nisen drejt fshatit Glloboçani, duke shfrytëzuar kanalin tashmë të njohur. Më 30 dhjetor aradha qëndron në fshatin Konjsko dhe formon Këshillin e parë nacionalçlirimtare në Maqedoni.

Më 31 dhjetor, disa orë para pritjes së Vitit të Ri, me propozimin e Behar Shtilës, Josifovski do të mbajë një ligjëratë nga lëmi i Marksizmit, edhe atë në gjuhën frenge (Josif Josifovski në prag të LNÇ-së kishte diplomuar në Fakultetin Juridik në Beograd).

Të nesërmen, pra më 1 janar të vitit 1943, Miço Sotiri me propozim të komesarit të tij nis për ta kërkuar aradhën e cila dukshëm u vonua. Budinski, Miçon do ta njoftojë me njëfarë Lefterin nga fshati Progri, ndërkaq Lefteri do ta angazhojë djalin e hoxhës së fshatit Abdullahun që ta shoqërojë Miçon për ta gjetur aradhën. Abdullahu dhe Miçoja do të shkojnë në Glloboçani dhe te Pande Komita takohen me partizanët tjerë të aradhës «Dame Gruev». Kështu, tani, e tërë aradha gjendej në te-



Josif Josifovski — Sveshtarot

rritorin e Shqipërisë dhe rreziku se do të ndjekej nga ana e fashistëve ishte shumë më i vogël.

(vijon)

Në numrin e ardhshëm: «LUTJËME PËR TË DREJTAT E NJE-RIUT»

Sh. Halimi

Luftojmë për të drejtat e njeriut

• Ç'THA KOMESARI GJORÇE SVESHTAR NË MITINGUN E CEROVËS?
— SI U FRIKËSUAN ITALINANËT QË GJINDESHIN NË FSHATIN
PUSTEC? — NDARJA E GRURIT

Pas pushimit disa orësh në shtëpinë e Pandes, të udhëhequr nga Miçoja dhe Abdullahu, shokët e aradhes, nëpër një mot të keq, nisen drejt fshatit Progri. Rruga që e vështirë, e pos kësaj ecjen e vështirësonte bora që reshte me të madhe. Shumica e partizanëve ishin të molisur, të zbatthur, pa çorapë. Pas dymbëdhjetë orëve udhëtimi, të lodhur, luftëtarët arritën në fshatin Progri, ku fshatratë u bë në një pritje të përzemërt. Po gjatë asaj dite, nga fshati Pojane, ku në ndërkohë kishte kaluar, arriti edhe komesari Josif Josifovski — Gjorçe Sveshtari.

Mitingu i madh në fshatin Cerovë

Katër ditë më vonë, përkatësisht më 6 janar të vitit 1943, aradha partizane »Dame Gruev« shkon në fshatin Cerovë, që shtrihet në afërsi të kufirit greko-shqiptar. Aradhes iu bashkua edhe Lefteri, Abdullahu dhe nja pesë shokë tjerë nga fshati Progri. Në këtë fshat, kryesisht të banuar me maqedonasë, u mbajt një miting i madh në të cilin foli Gjorçe Sveshtari. Ai, mes tjerash do të thotë:

»Të nderuar shokë e shoqe, dëshirave tua për mirë se ardhje po ju përgjigjemi — mirë se ju gjetëm. Erdhëm si ushtri maqedonase dhe luftojmë për të drejtat e popullit, për të drejtat e njeriut. Shumë kush deri më

tani dëshironte që të na ngarkojë edhe më të rëndë. Armiqtë tanë erdhën nga largësitë e ndryshme — nga Gjermania, Italia dhe nga Bullgaria. Ata nuk erdhën për të mirën tonë, përkundrazi, erdhën për të na lidhur me pranga të reja. Por, ne, të vëllazëruar me shqiptarët dhe popujt tjerë, ngritëm grushin kundër këtyre okupuesve. S'do mend se ne këtë luftë do

ta fitojmë, e për këtë thellë jemi të bindur. Në anën tonë janë aleatët e mdhenj, andaj edhe ne duhet ta japim kontributin tonë...«

Si u frikësuan italianët?

Pas qëndrimit në këtë fshat, gohen nga fshati pa krisur asnjë plumb. Kjo njësi e italianëve në fshatin Pustec ruante një hambar të madh me grurë. Fill pas kësaj, në Pustec ftohen të gj-

MITE BOGOEVSKI

U lind më 31 tetor 1919 në fshatin Bolno. Në vitin 1935 shkon në Manastir (Bitollë) dhe regjistrohet në Akademi në e tregtisë. Në vitin 1937 inkadrohet në Organizatën e të rinjve (SKOJ). Në vitin 1939, pas mbarimit të Akademisë, regjistrohet në Fakultetin Ekonomik në Beograd dhe njëkohësisht bëhet anëtar i PKJ-së. Për shkak të aktiviteteve revolucionare, më 16 shtator 1940 kapet nga policia dhe burgoset. Pas qëndrimit dymujsh në burg kthehet në Prespë dhe vazhdon aktivitetin në organizatat partiake. Me angazhimin e tij, më 6 korrik 1942 formohet aradha partizane »Dame Gruev«. Në 12 shtator 1942 duke mos dashur të bie në duart e fashistëve bullga-

rë Mite Bogoevski plumbin e fundit ia kthen vetvetes.

Më 2 gusht 1949, Mite Bogoevski shpallet hero i popullit.



Mite Bogoevski



S'harrohet mikpritja që na ofruan në Shqipëri — Krume Dimitrovski — Miço sot

aradha partizane »Dame Gruev« do t'i vizitojë edhe fshatrat tjetër kryepileqë të fshatrave tjerë si Zërnovce, Leska, Pustec, Shulin etj. Me këtë rast, vlen të përmendet qëndrimi i aradhes në fshatin Zërnovce, prej ky Josif Josifovski — Sveshtar do it' shkruajë një letër komandantit të një njësie italiane që gjindej në fshatin Pustec. Mes tjerash në letër thuhet se, po që se brenda 24 orëve nuk largohen italianët nga fshati, atëherë aradha partizane »Dame Gruev« do ta likuidojë tërë njësinë, duke e bombarduar nga të gjitha anët. Në këtë mënyrë, italianët në krye me komandantin e tyre, duke menduar se partizanët vërtet posedojnë topa, larpërreth, me ç'rast bëhet ndarja e grurit. (vijon)

Në numrin e ardhshëm: »SHPË TIM NGA SHKATËRRIMI I PLOTË«

Sh. HALIMI